



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004 / 12

PËR STANDARDIZIMIN

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullorës nr.2001/9 të datës 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, sipas nenit 5.1(ç), 9.1.1, 9.3.3, 11.2,

Miraton:

LIGJIN PËR STANDARDIZIMIN

KREU I

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Ky ligj vendos rregullat për procedurat e hartimit, përshtatjes, përvetësimit miratimit dhe aplikimit të standardave në Kosovë; përcaktimit të statusit të tyre; certifikimit të produkteve, proceseve, shërbimeve, sistemeve të cilësisë dhe personelit, me qëllim të mbrojtjes dhe aplikimit të standardeve në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare në mënyrë që të sigurohet një nivel i caktuar i cilësisë, me përjashtim të rasteve kur në ligj përcaktohet ndryshe.

Neni 2

Termet e mëposhtëm në këtë ligj kanë këto kuptime:

Standardizim – është veprimtaria për përcaktimin e standardeve me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e gjithë atyre që janë të interesuar.

Standard - është specifikimi teknik, i miratuar nga Agjencia për Standardizim e Kosovës, për përdorim të vazhdueshëm, aplikimi i të cilëve është i paobligueshëm dhe shërben si dokument për arritjen e nivelit të cilësisë.

Certifikim – është procedura e dhënies së dokumentit për konformitetin dhe sigurinë (vërtetimi mbi plotësimin e kërkesave për produkt, proces apo shërbim), e cila kryhet nga një palë e tretë dhe e paanëshme për vlerësimin e konformitetit dhe sigurisë së produkteve, proceseve, shërbimeve dhe sistemeve të cilësisë: sipas kërkesave të standardeve, specifikimeve teknike, kërkesave teknike, kërkesave të tjera ose akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kërkesë - është dispozita në të cilën janë të definuara të gjitha kriteret, të cilat duhet të plotësohen.

Produkt - është çdo produkt i prodhuar në mënyrë industriale dhe bujqësore, duke përfshirë edhe produktet e peshkut, të destinuara për treg.

Deklaratë e Prodhimit të Produktit – është dokumenti, i cili përmban të dhënat që identifikojnë produktin, prodhuesin dhe karakteristikat bazë të produktit.

Prodhues- është ai, i cili e krijon, prodhon dhe furnizon produktin ose vendos në produkt emrin dhe shenjën e tij dalluese, e cila e identifikon atë si prodhues.

Konformitet – është plotësimi nga një produkt, proces apo shërbim i kërkesave të specifikuara.

Vlerësimi i Konformitetit- është çdo veprimtari e drejtëpërdrejtë apo e tërthortë që përcakton nëse është plotësuar tërësia e kërkesave teknike, të vendosura në dokumentacionin përkatës.

Shenja e Konformitetit- është shenja dalluese, e cila vendoset mbi një produkt ose ambalazhin e tij, për të dëshmuar se produkti i plotëson kriteret e vendosura me standardin ose specifikimet teknike, të cilave ju referohet.

Deklaratë e Konformitetit- është dokumenti me të cilin prodhuesi deklaron nën përgjegjësinë e vet personale, se produkti, procesi apo shërbimi i ofruar prej tij është konform një specifikimi teknik.

Rregullat Teknike - janë aktet nënligjore me karakter teknik të cilat i përcaktojnë karakteristikat e produkteve, proceset e prodhimit të tyre, ku përfshihen edhe masat administrative që zbatohen në rast të shkeljes së tyre. Rregullat teknike mund të përmbajnë terminologjinë, simbolet, ambalazhin, shënjimet ose kërkesat për etiketimin që kanë të bëjnë me produktin, procesin apo metodën e prodhimit.

Specifikimet Teknike – janë specifikimet e dhëna në një dokument, të cilat japin karakteristikat e kërkuara për një produkt si: niveli i cilësisë, vetitë teknike, kryesore dhe dytësore, sigurinë, përmasat, provat, metodat e analizave, paketimin, etiketimin, procedurat për vlerësimin e konformitetit etj.

Projekt Standard- është dokumenti që përmban tekstin e specifikimeve teknike për një subjekt të caktuar, i cili mund të miratohet në përputhje me procedurën e standardeve në vend, dhe pas hartimit qarkullon për shqyrtime dhe komente.

Sistemi i Cilësisë – është e gjithë struktura organizative, procedurat, proceset dhe burimet që i nevojiten një subjekti për të arritur cilësinë së kërkuar. Sistemi i cilësisë bazohet mbi bazën e serisë së standardeve ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve (ISO) dhe Normave Europiane (EN).

Palë e Tretë – është organizmi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit të produktit, procesit ose shërbimit, nga njëra anë dhe prodhuesit dhe shpërndarësit, nga ana tjetër të cilët i nënshtrohen këtij vlerësimi.

Agjencia për Standardizim e Kosovës (ASK) është Agjencia ekzekutive në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

KREU II Standardet

Neni 3

- 3.1. Standardet mund të jenë vendore dhe ndërkombëtare.
- 3.2. Si pika referuese për standardet janë standardet ndërkombëtare, regjionale dhe të vendeve të zhvilluara , si dhe të arriturat e shkencës dhe praktikës.

Neni 4

- 4.1. Standardet kanë të njëjten vlerë për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Kosovë. Standardet ose pjesë të tyre përdoren si baza referuese për rregulloret apo normativat e tjera, ligjet dhe aktet nënligjore si dhe për rregullat teknike.
- 4.2. Standardet eksperimentale përcaktojnë kërkesat për cilësinë e prodhimeve, ndërtimeve dhe shërbimeve të reja. Me përvetësimin e teknologjisë ekziston mundësia për rishikimin dhe freskimin e standardeve. Standardi eksperimental nuk mund të merret si bazë referimi për hartimin e rregullave të reja teknike.
- 4.3. ASK-ja i jep përparësi hartimit, përshtatjes, përvetësimit dhe miratimit të një standardi që shërben si bazë referimi për hartimin rregullave teknike të nevojshme për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.
- 4.4. Standardet ndërkombëtare, evropiane apo ato të shteteve të tjera, përshtaten ose përvetësohen si standarde të Kosovës me qëllim që t'i shërbejnë interesave të Kosovës, thithjes së teknologjive të reja si dhe të lehtësojnë shkëmbimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve me vendet e tjera.

Neni 5

- 5.1. Standardet ose pjesë të tyre, kur vlerësohet e nevojshme, përdoren si referencë për rregulloret ose normativat e tjera, aktet ligjore dhe nënligjore si dhe për dipsozitat teknike.
- 5.2. Nisma për hartimin e projektstandardeve merret nga personat fizikë dhe juridikë ose nga ASK-ja, e cila ka përgjegjësinë e aprovimit të standardeve.
- 5.3. Përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore e publike, bashkëpunojnë me ASK-në për hartimin, rishikimin, përshtatjen dhe përvetësimin e standardeve ndërkombëtare, evropiane apo të ndonjë shteti tjetër në lëmitë përkatëse të tyre.
- 5.4. Ministrinë e interesuara bashkëpunojnë me ASK-në me qëllim që personat fizikë dhe juridikë t'i zbatojnë këto standarde në veprimtarinë e tyre.

Neni 6

6.1. Standardet dhe dokumentet e origjinës, të cilat i lëshon ASK-ja, kanë shenjën dalluese të Agjencisë.

6.2. Standardet dhe dokumentet e origjinës lëshohen sipas rregullave të ASK-së.

6.3. ASK-ja ka të drejtën ekskluzive për publikimin dhe shitjen e standardeve. ASK-ja mund t'ia delegojë këtë të drejtë ndonjë subjekti tjetër të kontraktuar qoftë me status publik ose privat.

6.4. Subjektet fizike dhe juridike obligohen t'i blejnë pranë ASK-së standardet, të cilat janë përdorur si referencë në aktet ligjore dhe nënligjore..

KREU III Rregullat Teknike

Neni 7

7.1. Rregullat teknike u referohen standardeve dhe përmbajnë kërkesat themelore për produkte, procese dhe shërbime të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit.

7.2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore publike detyrohen të hartojnë, miratojnë dhe të ndjekin zbatimin e rregullave teknike në të gjitha fushat e veprimtarisë që mbulojnë.

Neni 8

Rregullat teknike kanë për qëllim:

- a. mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të shëndetit të tyre, mbrojtjen e ambientit dhe vlerave të tjera të natyrës, si dhe mbrojtjen e ambientit të punë së njeriut;
- b. sigurimin teknik të objekteve, pajisjeve, veglave dhe procesit të punës;
- c. mbrojtjen e konsumatorit të produkteve dhe shfrytëzuesit të shërbimeve, mbrojtjen përkatë të interesit të pjesëmarrësit në një proces të caktuar.

Neni 9

Rregullat teknike përmbajnë veçanërisht:

- a. kërkesat teknike dhe kërkesat tjera për produktet, proceset dhe shërbimet;
- b. sistemin e vlerësimit të konformitetit me rregullat dhe kërkesat;
- c. kushtet për ndërmarrjet ose personat e tjerë juridik që autorizohet për vlerësimin e konformitetit;
- d. dokumentet (certifikatat) që duhet të ekspozohen krahas produktit;
- e. mënyrën e shënimit, paketimit, deklarimit dhe të ngjashme;
- f. mënyrën e shënimit të produktit me shenjën e konformitetit;

Neni 10

10.1. Propozimin për rregulla të reja teknike ministrisë përkatëse mund t'ia bëjnë institucionet e tjera qëndrore si dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë.

10.2. Ministria përkatëse sjell programin mbi krijimin e rregullave të reja teknike, ndryshimet dhe plotësimet e rregullave teknike aktuale .

10.3. Materialin bazë të rregullave teknike e shqyrton organi profesional nga radhët e ekspertëve të fushveprimtarisë përkatëse, ose një organ i specializuar në këtë fushë, i cili emërohet nga Ministria përkatëse.

Neni 11

11.1. Materiali i rregullave teknike shqyrtohet në atë mënyrë që u mundëson të interesuarve të japin mendimet, vërejtjet dhe propozimet e tyre.

11.2. Titulli dhe materiali bazë i rregullave teknike, afati për të dhënë vërejtje dhe rekomandime, titulli i bartësit të rregullave teknike, si dhe të dhëna se si sigurohet materiali bazë, publikohen në gazetën zyrtare dhe sipas nevojës edhe në publikime tjera.

11.3. Afati për vërejtje nuk duhet të jetë më i shkurtër se 60 ditë nga dita e publikimit të materialit bazë, përveçse nëse gjenden shkaqe të natyrës së sigurisë, mbrojtjes së shëndetit dhe ambientit.

Neni 12

12.1. Prurësi i rregullave teknike për vlerësimin e konformitetit autorizon ndërmarrjen ose një person tjetër juridik që të caktojë kushtet specifike në pajtim me rregullat teknike.

- a. të ketë kuadër të aftësuar profesional;
- b. të ketë përgatitje të mjaftueshme teknike;
- c. të jetë i aftë të sigurojë paanshmëri;
- d. të jetë i aftë të sigurojë fshehtësinë e të dhënave;
- e. që me kontratë të ketë siguar aktivitetet që nuk mund t'i kryejë vetë;
- f. të jetë i regjistruar për këtë veprimtari;
- g. të jetë i akredituar;
- h. kushte të tjera që sigurojnë zbatimin e detyrave të përshkuara.

12.2. Prurësi i kushteve teknike lëshon vendimin mbi autorizimin e ndërmarrjes ose personit tjetër juridik për vlerësimin e konformitetit të produktit, procesit dhe shërbimit me rregullat teknike dhe kryen kontrole periodike mbi përmbushjen e kushteve.

KREU IV

Deklarimi dhe Verifikimi i Konformitetit

Neni 13

13.1. Të gjitha produktet, proceset dhe shërbimet e tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit, për të cilat duhen respektuar aktet ligjore dhe nënligjore apo rregullat teknike përkatëse, i nënshtrohen procedurës së çertifikimit të detyruar dhe dhënies së shenjës së sigurisë.

13.2. Kërkesa për certifikim bëhet nga ministrinë përkatëse.

13.3. Për të gjitha produktet, proceset apo shërbimet e tjera, procedura e certifikimit (dhënia e shenjës së konformitetit), kryhet mbi baza të paobligueshme dhe sipas akteve nënligjore.

13.4. Analizat e ekspertizave dhe kontrolli produkteve, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit, kryhen vetëm në laboratorët e akredituar.

Neni 14

Deklarimi i konformitetit të një produkti, procesi apo shërbimi sipas një standardi është i lirë të kryhet nën përgjegjësinë personale të prodhuesit apo tregtuesit, nëpërmjet një dokumenti, kur produkti, procesi apo shërbimi nuk përputhet me rregulla teknike.

KREU V Agjencia e Standardizimit

Neni 15

Për drejtimin, organizimin dhe kontrollin e veprimtarisë së standardizimit, akreditimit, certifikimit dhe sigurimit të sistemeve të cilësisë në Kosovë është përgjegjëse Agjencia për Standardizim e Kosovës.

Neni 16

16.1. ASK-ja është institucion ekzekutiv me seli në Prishtinë, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe që drejtohet nga Kryeshefi Ekzekutiv.

16.2. Themelimi dhe mjetet për punë të ASK-së sigurohen nga mjetet e buxhetit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 17

ASK-ja është kompetente për:

- a. organizimin dhe përcjelljen e procedurave të hartimit, miratimit dhe aplikimit të standardeve, certifikimit të produkteve, shërbimeve, sistemeve të cilësisë dhe personelit;
- b. organizimin dhe përcjelljen e procedurave të standardizimit, akreditimit dhe certifikimit duke u mbështetur në standardet e organizmave ndërkombëtare dhe evropiane të standardizimit;
- c. miratimin, përshtatjen, përvetësimin si standarde vendore të standardeve ndërkombëtare, evropiane dhe ato të vendeve tjera, me përjashtim të standardeve në fushën e telekomunikacionit.;
- d. rishikimin e standardeve vendore ekzistuese;
- e. akreditimin e laboratorëve të provave të cilësisë, trupave certifikuese dhe atyre inspektuese.
- f. përfaqësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale për fushat e veprimtarisë të përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, duke pasur parasysh marrëveshjet ndërkombëtare ku vendi ynë është palë;

- g. lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet homologe të shteteve të tjera, për informacionin, shkëmbimin e literaturës, përvojën dhe kualifikimin e kuadrave për fushat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, me synim lehtësimin e tregtisë dhe çështjeve me interes të ndërsjelltë.
- h. lidhjen e marrëveshjeve me organet homologe të vendeve të tjera për njohjen e ndërsjellë të raport-analizave të laboratorëve të akredituar, të shenjave tregtare, etiketave dhe materialeve të ngjashme në lidhje me konformitetin dhe sigurinë.
- i. nxitjen e studimeve, botimeve, kërkimeve shkencore dhe bashkëpunimin në fushat që kanë të bëjnë me standartet dhe standardizimin. Nxitjen dhe bashkërendimin e nismave, me karakter shkencor, teknik dhe kulturor që kanë të bëjnë me standartet dhe standartizimin;
- j. mbajtjen dhe administrimin e arkivit të standardeve vendore dhe të huaja dhe dhënien e informatave, sipas nevojave, subjekteve vendase dhe të huaja që kryejnë veprimtari ekonomike në territorin e Kosovës,
- k. përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për veprimtari që mbulon ajo;
- l. propozimin e tarifave për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për shërbimet që Agjencia kryen për të tretët.

KREU VI Dispozitat Ndëshkuese

Neni 18

Shkeljet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, nëse nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë prej 100 € deri 1000 €.

Neni 19

Punonjësit e autorizuar të ASK-së kanë të drejtën e vënies së gjobës për shkeljen e dispozitave të dhëna në nenin 18.

Neni 20

Pala e pakënaqur me dënimin administrativ për shkelje të dispozitave nga neni 6, ka të drejtë ankese. Ankesa i drejtohet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit .

Neni 21

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave të këtij ligji derdhën në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

KREU VII
Dispozitat kalimtare

Neni 22

Agjencia për Standardizim e Kosovës i kryen kompetencat e veta në bashkëpunim me UNMIK-un, sipas nenit 17 pika f, g, h.

KREU VIII
Dispozitat Përfundimtare

Neni 23

Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha aktet e tjera normative që rregullojnë çështjen e standartizimit në Kosovë.

Neni 24

Ministritë përkatëse nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga PSSP-ja.

Ligji Nr.2004 / 12
29 Prill 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci